 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 1/1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 7. Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 9 : Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 10 Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

Shtojca 11- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 12 : Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 1/1.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët]

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

c) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlere absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					

Datë _____	
-------------------	--

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

- Motorrat e urgjences të plotësojnë standartet e percaktuara nga Rregullorja e Parlamentit European 168/2013 (e ndryshuar në vitin 2018) "Homologimi dhe mbikëqyrja e tregut për motorrat me dy, tre dhe katër rrota", kategoria L5e.
Per kete duhet te jene te pajisur me Certifikaten e Homologimit, ose ekuivalent.
- Motori i urgjences të jetë i pajisur me Certificate Konformiteti / CE ose ekuivalent.
- Pajisjet mjeksore të plotësojnë standartin UE 2017/745 ose ekuivalent.
- Të gjitha pajisjet e tjera të plotësojnë standartin CE ose ekuivalent.
- Prodhuesit e motorave dhe pajisjeve duhet të plotësojnë standartet e cilësisë ISO 9001:2015 ose ekuivalent.
- Të gjithë motorat duhet të jenë i njeti model, tip dhe vit prodhimi.
- Furnizimi dhe montimi i pajisjeve dhe atrecaturës, sipas kërkesave të dhena nga AK, duhet të kryhet nga prodhuesi ose një operator i autorizuar prej tij dhe i certifikuar sipas legjislacionit në fuqi.
- Motorat e urgjences duhet të furnizohet të pajisura me manualin teknik, manualin e shërbimit, Flete Garancine dhe të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

I. KERKESAT PER FUNKSIONIMIN

Motori duket te siguroje:

- Lëvizshmëri shumë e mirë në trafikun e qytetit.

- Kosto të ulëta të menaxhimit.
- Koha e shpejtë e ndërhyrjes.
- Mundësi për të diferencuar llojin e ndërhyrjes që kërkohet.
- Te garantojë më shumë stabilitet dhe siguri me ane të 3 rrotave dhe 3 disqeve të frenave në frenim, në kthesa, në sipërfaqe të rrëshqitshme, gropa etj.
- Te mos ketë nevojë për trekëmbësh(këmbalec) për parkim.
- Mbrojtje nga agjentët atmosferikë: aksesori të mbulesës së këmbëve, dorashkave dhe xhamit të lartë.
- Lidhshmëria me smartphone: vizibiliteti në ekranin e motorrit të thirrjeve hyrëse dhe dalëse, GPS, dërgimi dhe marja e mesazheve e mesazheve.
- Sistem Roll Lock: pajisje elektro-mekanike e cila, nëse aktivizohet nga shoferi, lejon të mbahet motorri i ndalur dhe në një pozicion vertikal pa përdorur këmbalecën, me qëllim fitimin e kohës.
- Konfigurimi specifik: drita të gjata, të shkurtra, fenelina, sirenat, komand kontrolli, instalimet elektrike të miratuara nga prodhuesi.
- Konsumit të ulët karburanti

Ndihmë brenda pak minutave

Në qytetet e mbushura me trafik, motorrat e urgjencës me mjek dhe infermier në bord janë më të shpejtë se autoambulancat. Ky avantazh duhet të jetë i dobishëm në:

- Ndihmën e parë në vendin e aksidentit
- Transmetimin e informacioneve në Njësinë e Koordinimit në raste eventesh madhore edhe për njësitë e tjera, si mjete më të shpejtë për të mbërritur në vendngjarje.
- Transporti i shpejtë në rast nevojë për gjak urgjent.

II. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË MOTORIT TE URGJENCES:

Të gjithë motorrat duhet të jenë i njëti model, tip dhe vit prodhimi.

Viti i prodhimit minimumi 2022

Tipi i motorit: Motor Benzine



Motore me një cilindër, 4 kohë, 4 valvola

Xham i përparmë, me përmasa, lartësia jo më pak se 1450 mm dhe gjerësia jo më pak se 550 mm.

Cilindrata 300-400 cc.

Fuqia 25-27 kW, 7.500 xhiro/min

Induksion elektronik

Kambio automatike

Ftohja me likuid

Freksioni automatik

Klasifikimi-Minimumi Euro 5

Struktura e sediljes me tub metali me rezistencë të lartë.

Amortizatorë të përparmë me impiant elektroidraulik me bllok të amortizatorëve.

Amortizatorët të pasëm dopio, amortizatorë hidraulik të rregullueshëm në parangarkesë lëshuar në 4 pozicione.

Frenat e rrotave të përparme me dopio disk Ø 250-260 mm

Frena e rrotave të pasme me disk Ø 235-245 mm

Kapaciteti i serbatorit 12-15 litra

Shpejtësia maksimale 130-140 km/h

Pesha deri në 260 kg (versioni standard, i pa kompletuar me pajisje)

Të ketë suport për fiksimin e cantës mjekësore në pjesën anësore dhe për fiksimin e valixhes në pjesën e pasme.

Aksesorët:

- Valixhe e pasme e motorrit



Valixhe e lëvizëshme me kapacitet jo më pak se 45 litra, e cmontueshme, e kapur me mekanizëm fiksues me trupin e motorrit.

Hapësirë poshtë sediles me kapacitet jo më pak se 45 litra.



Sirena

Të ketë dy sirena vendosura në pjesën e përparme, poshtë pasqyrave, të homologuara për motorr.



Drita led dhe fenelina, me ngjyrë blu, për motorra



Të ketë dy fenelina blu në të dy krahët e timonit poshtë sirenave.

Tub teleskopik me dritë feneline me ngjyrë blu që rrotullohet 360° gradë.



Te këtë një fenelinë të vendosur në pjesën e pasme të motorrit, në krahun e djathtë, në pjesën e sipërme të një tubi metalik teleskopik.

Tubi të këtë gjatësi nga 60-100 cm, e rregullueshme.

Adesiv fosforeshent me shikueshmëri të lartë

III. PAJISJE DHE MATERIALE TË MOTORIT TË URGJENCËS.

1. Set diagnostikimi i parametrave jetësor (stetoskop, termometër, glukometër, sfigomanometër, pulsoksimetër).
2. Monitordefibrilator
3. Bllokues i kollonës cervikale (qafore 3 masa)
4. Bombul oksigjeni 2 litër
5. 1 Cantë e madhe anësore (me canta të vogla për sete)

1. Set diagnostikimi i parametrave jetësor, i përbërë si më poshtë:

-Aparat tensioni portabël (sfigmomanometer), lehtësisht i lexueshem nga çdo kënd. Manshetat e përfshira si për adult dhe pediatrik.



-**Stetoskopi** të përbëhet nga membranë që dedektojnë dhe amplifikojnë zhurmat kardiake dhe ato respiratore. Koka e përbërë prej inoksi që të dedektojë dhe tinguj me frekuencë të ulët.



-Termometri elektronik ose manual



Pajisja elektronike për matjen e temperaturës së trupit, i thjeshtë në përdorim dhe me precizion të lartë

-**Pulsoksimetër** për matjen e sasisë së oksigjenit në gjak.



-**Glukometër** dhe strishot për glukometër



Me sistem për matjen e sasisë së glukozës në gjak.

Të masë sasinë e glukozës në gjak, duke e nxjerrë atë nga shiritat në të cilën është hedhur një pikë e gjakut kapilar, shiritat /strishot janë reaktive në sajë të elektrodës me sensorë.

2. Monitordefibrilator

Të plotësojë karakteristikat si më poshtë:

Të ketë selektor në tre pozicione

Të ketë dy bateri

Pozicion për defibrilim manual, dhe të sinkronizuar për goditje elektrike me piastra manuale.

Pozicion AED (Automatic External Defibrillation), që do të thotë semiautomatik, që kryen defibrilim me piastra autoadezive.

Pozicion monitorimi dhe regjistrimi të EKG (Elektrokardiograma).

Të ketë monitor me ngjyra TFT-LCD, rezistent kundrejt goditjeve dhe demtimeve, ku të pasqyrohen 12 kanalet e EKG, saturimi i O₂, pulsi, parametrat jetësor, alarmet etj.

Diapazoni i shkakitimit të energjisë 1-250J

Koha e karikimit të monitordefibrilatorit për goditje elektrike të jetë jo më shumë se 8 sekonda për 360 J.

Minimumi i kohëzgjatjes së baterisë të jetë jo më pakë se 5 orë

Impuls bifazik që ndryshon sipas specifikave të pacientit në Automatic Mode

EKG 12 kanale

Pulsoksimetri (saturimi i O₂)

Mates tensioni NIBP për të rritur dhe neonatal

Printer termal të integruar për të printuar EKG-ne 12 kanalshe

Çantë monitordefibrilatori me rrip mbajtës dhe xhepa anësorë të integruar për ruajtje nga dëmtimet dhe transport të shpejtë të aksesorëve

Memorje për ruajtjen e të dhënave minimum 3 GB

Elektroda pediatrike dhe adulte të integruara

Elektoda ngjitëse për defibrilim automatic dhe pacemaker

Aksesori SPO2 Pulsoksimetri

Aksesori NIBP (presioni arterial)

Mbajtës dhe karikues baterie në lëvizje,

Të ketë mbrojtjen jo më pak se IP X3

3. Bllokues i kollonës cervikale (qafore 3 masa)



- Të jetë me përmasat jo më pak se 30x30 cm
- Të garantojë gjatë lëvizjes së të dëmtuarit një imobilizim sipas aksit anatomik të sigurt të vertebrave cervikale.
- Të sigurojë kontroll të lëvizjeve aksiale dhe përkuljeve laterale të kollonës.
- Të jetë e realizuar me material polietileni me densitet të ulët, që siguron pastrim të lehtë.
- Të jetë fleksibël në aplikim, dhe me strukturë të ngurtë për imobilizim.
- Të ketë një hapje të përparme për të lehtësuar aksesin e trakeotomisë

4. Një bombul me reduktor dhe fluksometer kapacitet dy litra

Bombël O2 e kompletuar me reduktor dhe fluksimetër.

Mund të mbajë O2 deri në presion 200 bar.

Reduktor me piston me filtër.

Rregulluesi i fluksit të O2 nga 0-15 litër /min

Presioni në dalje të reduktorit 3-4 bar

Materiali: Celik, polietileni, Alumin, Tunxh i kromuar.

- Reduktor oksigjeni

Reduktor presioni me përllogaritje fikse të përshtatshme për lidhje direkte me bombulën e

O2. Manometri lejon një lexim të shpejtë të presionit të bombulës në bar. Lidhja e hyrjes sipas standarteve UNI. Valvul sigurie.

Filtër bronzi i integruar te reduktori.

5. 1 Cantë e madhe anësore (me canta të vogla ose ndarje për sete)



- Me qepje dhe me ngjitje
- Me ndarje të brendshme ose me 3 çanta të vogla
- Të mbyllet me zinxhirë
- Mund të ketë xhepa anësore me zinxhirë
- Të jetë e përshtatshme për vendosjen e seteve të ndryshme (infuzioni, mjekimi, intubimi etj)
- Të jetë e përbërë nga material shumë rezistent me kapacitet të lartë mbajtës dhe me strisho fosforeshente.
- Të jetë e papërshkrueshme nga uji dhe agjentët atmosferikë.
- Kapacitet mbajtës jo më pak se 10 litër.
- Përmasat jo më pak se 250 * 400 * 220 mm
- Të jetë e fiksuar dhe e sigurt me trupin e motorrit gjatë lëvizjes.



Aplikimi i një shiriti perimetral fosforeshent autoadeziv me ngjyrë portokalli me gjerësi 5-7 cm, e përshtatshme me hapësirën ku mund të shkruhet.

Shkrimi AMBULANCA, në të kundërt, me ngjyrë të bardhë, në pjesët anësore të pjesës së përparme të motorrit, poshtë dorezave të timonit, anash dritave, sipër gomave të përparme.

Shkrimi në pjesët anësore të motorrit URGJENCA 127 dhe Kryqi i Eskulapit, anash sediljes, në të dy anët, sipër gomës së pasme.

Në xham të jetë i vendosur Kryqi i Eskulapit.

Mbulesë mbrojtëse për këmbët



- Projektuar në formën e mjetit për mbarojtjen e këmbëve të drejtuesit
- Rezistent ndaj ujit
- Modular dhe lehtësisht i konvertueshëm sipas kushteve të motit
- Material termik për mbrojtje në temperatura të ulta dhe gjatë lëvizjes

Kit suporti për smartphone



- I përshtatshëm për telefonat inteligjentë
- Mbajtëse të timonit/pasqyrës që është e lehtë për t'u montuar
- Mbulesë smartphone me gomë të butë rezistente ndaj goditjeve, me lidhës të integruar për mbështetje
- Mbulesë transparente të papërshkueshme nga uji
- Mundësi rrotullimi deri në 90°

GPS



- Të jetë kompatibël për sistem GPS

Mbulesa duarsh te timoni



- Material i papërshkueshëm nga uji
- Material termik për të siguruar mbrojtje të përsosur në temperatura të ulëta

Kasko modulare



- Sistem ABS
- Dizajn modern dhe aerodinamik
- E brendshme në pëlhurë hipoalergjike të lëvizshme dhe e lashme
- Xham i lëvizshëm për mbrojtje nga dielli i integruar në pjesën e përparme të kaskës
- Xham i gjerë kundër gërvishtjeve për mbrojtje nga era dhe agjentët atmosferikë dhe me mekanizëm mbylljeje të lehtë automatike
- Ventilim për qarkullim optimal të ajrit
- Të ketë dy kasko

Sistem komunikimi bluetooth



- Lidhje Bluetooth me telefonat
- 2 kufje stereo
- Aftësia për të ndjekur udhëzimet GPS
- Mikrofon i integruar me portë mikro USB
- Funkzioni i përgjigjes së thirrjeve me komandë zanore
- Dritë LED që tregon statusin e pajisjes

Periudha e garancisë:

- 5 vjet për motorrin
- 2 vjet për pajisjet mjekësore

Afati i ekzekutimit: 75 ditë nga nënshkrimi i kontratës

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Motorra urgjence	4	Qendra Kombetare e Urgjences Mjekesore	Jo më vonë 75 ditë nga nënshkrimi i kontratës

Afati i levrimit jo me vone se 75 dite nga nenshkrimi i kontrates.

Vnedi i dorezimit te mallrave: Qendra Kombetare e Urgjences Mjekesore, rruga “Lord Bajron”, nr.70, Laprake, Tirane.

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të jetë i pajisur me Licencën e kategorisë, “VII.3.B.2 - Shitblerja e mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove te reja ose te perdorura”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

2.3Kapaciteti teknik:

1. 1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit.** Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2. Operatori ekonomik duhet të provojë që është i autorizuar nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, për këtë objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

2. Në mënyrë që të mbulohet shërbimi i ofrimit të garancisë, operatori ekonomik duhet të ketë dhe të paraqesë listën e serviseve në pronësi, me qera ose mënyra të tjera të parashikuara në legjislacionin në fuqi të cilat detyrimisht duhen të jenë të pajisur me dokumentacion si më poshtë:

- Licencën e kategorisë VII.3.B.1, “Riparimi dhe mirembajtja e pjeseve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për pikat a, c, ç, në përputhje me legjislacionin, për lejet dhe licencat, si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, me nr.1546, datë 29.03.2016, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për ambientin ku ushtron këtë aktivitet;
- Kontratën e qerasë/huapërdorjes/ ose mënyra të tjera të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë që garanton dhe merr përsipër se motorri dhe pajisjet mjekësore që do të ofertojnë janë të prodhuara dhe përmbushin kërkesat, certifikimet dhe standartet e cilësisë të përcaktuara në specifikimet teknike në DST, si dhe faktin se të gjitha certifikatat për standartet e cilësisë duhet të shoqërojnë mallin në momentin e marrjes në dorëzim.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë teknikë/broshura ose çdo lloj dokumentacioni tjetër teknik, ku të përfshihen specifikimet teknike të motorrit të përkthyer dhe noterizuar. Në katalogë/ broshura duhet të markohen (për lehtësi identifikimi) specifikimet teknike të kërkuara në Shtojcën 5 të DT.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë teknikë/ broshura ose çdo lloj dokumentacioni tjetër teknik, të pajisjeve dhe seteve mjekësore, që vërteton plotësimin e specifikimeve teknike, të përkthyer dhe noterizuar. Në katalogë/ broshura duhet të markohen (për lehtësi identifikimi) specifikimet teknike të kërkuara në Shtojcën 5 të DT.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë që merr përsipër dhe garanton mbulimin e periudhës së garancisë sipas përcaktimeve në specifikimet teknike në DST (duke përfshirë 5 vjet garancinë për motorrin, dhe 2 vjet garancinë për pajisjet mjekësore)

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë që malli i ofruar (motorrat, pajisjet dhe setet mjekësore) janë të reja, të papërdorura dhe origjinale.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----

Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- -----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se, deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
 - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).



7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
- a) çmimet ;
 - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
 - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
 - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata
